

**FTESË PËR PJESËMARRJE NË PUNËTORINË; ORIENTIMI&TRAINIMI
PROJEKTI I KRAHASIMIT TË STANDARDIZUAR/BENCHMARKING PËR 2014-2015 /EBC**

Për: Shoqëritë e Ujësllësive dhe Kanalizimeve Kosovë-Shqipëri

Nga: SHUKOS&SHUKALB/ HUB Kosovë &Shqipëri)

Data: 22 qershor 2015

Të nderuar kolegë,

Kemi kënaqesinë të ju ftojme në takimin e parë njoftues mbi Programin e krahasimit të standardizuar/ Benchmarking EBC-European Benchmarking Cooperation/ I mbështetur nga Banka Botërore dhe Shoqata Ndërkombëtare e Ujësllësive në zonën ujëmbledhëse të Danubit (IAWD) në kuadër të Programit të ujit të Danubit, një program për asistencë teknike që ka për qëllim përmirësimin e shërbimeve të ujit dhe kanalizimeve në rajonin e Danubit.

Një nga aktivitetet e këtij programi është edhe ky i krahasimit të standardizuar/ Benchmarking, si një mjet menaxhimi për të përmirësuar performancën e shoqërive ujësllës kanalizime duke mësuar nga njëri-tjetri.

Grupimi i vendeve Kosovë dhe Shqipëri ka si objektiv pjesëmarrjen në këtë program të krahasimit të standardizuar/ Benchmarking për të përfituar nga kjo eksperiencë dhe për të dhënë një kontribut të vlefshëm në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Para fillimit të ushtrimit të dytë, një punëtori Orientimi & Trajnim (kick-off) organizohet për shërbimet e mundshme të interesuara dhe tashmë të regjistruara për këtë program.

Objektivi kryesor i projektit është të bëjë krahasimin e standardizuar/benchmarking të shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza, me të dhënat e vitit 2013 (pilot ushtrimi i parë në v.2014 të riplotësohet pararelisht në fajlin e excelit) dhe të dhënat e vitit 2014 (ushtrimi i dytë në vitin 2015-po fillojmë).

Programi i krahasimit të standardizuar/ Benchmarking do të koordinohet nga Znj.Nadire Vitija (përfaqësuese e SHUKOS) dhe Znj.Daniela Gega (përfaqësuese e SHUKALB), në bashkëpunim të ngushtë me EBC (Bashkëpunimin Evropian të krahasimit të standardizuar/Benchmarking).

Objektivat e punëtorisë (1-ditore) janë:

- Për të bërë menaxhmentin e shërbimeve të kuptojnë domethënien dhe vlerën e krahasimit të standardizuar/benchmarking;
 - Për të shpjeguar procesin e krahasimit të standardizuar-benchmarking;
 - Për të trajnuar në mënyrë të veçantë koordinatorët e shërbimeve me metodologjinë dhe mbledhjen e të dhënave për krahasim të standardizuar /Benchmarking.
- Gjithashtu, situata individuale mund të diskutohen.

Objektivat e trajnimit janë:

- për të marrë njohuri mbi bazat e standardizimit
- për të marrë njohuri mbi metodologjinë dhe procesin e EBC
- të përjetojnë një stërvitje mbi standardet, nga perspektiva e një pjesëmarrësi
- për të filluar me regjistrimin e të dhënave për ushtrimin e dytë.

Ne ju ftojme përzemërsisht për të marrë pjesë në trajnim dhe urojmë mbarëvajtjen e programit në drejtim të krijimit të mekanizmit të fuqishëm të krahasimit dhe krijimit të mundësive të reja për përkrahje ndërkombëtare.

Vend i takimit;PRISHTINE
Data;30.06.2014 (e marte)

AXHENDA

- 9.30-10.00 Arritja e pjesëmarrësve/ Regjistrimi
10.00-10.30 Mirëseardhje/Prezantimi dhe Njoftimi i pjesëmarrësve
- 10.30-12.30 Njohuri mbi bazat e standardizimit/ domethënien dhe vlerën e krahasimit-
benchmarking/ HUB KOSOVE SHQIPËRI
- njohuri mbi metodologjinë dhe procesin e EBC
- stërvitje mbi standardet, nga perspektiva e një pjesëmarrësi
-njohja me koordinatorët kolegë nga rajoni dhe EBC
Diskutim interaktiv/shkëmbim njohurish dhe përvoja
- 12.30-13.00 Pauze për kafe
- 13.00-13.30 Programi dhe procesi i krahasimit të standardizuar-benchmarking;
13.30-14.30 Trajnimi në mënyrë të veçantë me koordinatorët e shërbimeve për krahasim të
standardizuar /Benchmarking me metodologjinë dhe mbledhjen e të dhënave EBC

Msc.Nadire Bejtullahu Vitija-SHUKOS dhe Daniela Gega- SHUKALB

14.30-16.00 Dreka e përbashkët
VARESISHT NGA QENDRIMI I KORDINATOREVE NGA SHQIPERIA DO KEMI DY ORE PUNE PRAKTIKE ME
PLATFORMEN E RE/QASJE NE SOFTWER PER FUTJEN E TE DHENAVE/ FILLIMIN E USHTRIMIT TE DYTE

Logjistika;

Pjesëmarrës të ftuar në këtë takim janë personat e regjistruar si kordinatorë në programin EBC. Ju kujtojmë qe posedimi I Laptopëve do të na lehtëson fillimin e punës po atë ditë.
Udhëtimi dhe akomodimi për pjesëmarrjen e kordinatorëve nga SHUK-Shqipëri mbulohen nga projekti.

Juaja sinqerisht,
Msc. Nadire Vitija
SHUKOS